REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA CËRRIK

Nr._____Prot **Cërrik, më:___.___.2026**

PROJEKT –VENDIM

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

“Për admnistrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e Bashkisë Cërrik”

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK BASHKIA CËRRIK

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 55/2025 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa”, ligjit nr. 107/2014 “Për zhvillimin e territorit”, VKM-ës nr. 155, datë 11.03.2022 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënes së të drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë” dhe VKM-ës nr. 189, datë 30.03.2022 “Për përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina” dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Cërrik,

PROPOZOJMË

1. Të miratohet rregullore “Për admnistrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e bashkisë Cërrik”.
2. Rregullorja përcakton rregullat për planifikimin, administrimin, koordinimin, ndërtimin dhe përdorimin e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike në territorin e bashkisë Cërrik, me qëllim zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet shumë të lartë, reduktimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve, nxitjen e përdorimit të pëbashkët të infrastrukturës passive, sistemimin gradual të rrjeteve ajrore, garantimin e aksesit në godina dhe infrastrukturën e brendshme të komunikimeve elektronike, mbështetjen e transformimit dixhital dhe zhvillimit urban të qëndrueshëm.
3. Miratimi I rregullores është një domosdoshmëri për standardizimin e rrjeteve kabllore ajrore dhe sistemimin e tyre nëpërmjet kalimit të tyre në kanale nëntokësore në zonat urbane, nëpërmjet infrastrukturave passive si: tubacione, mikrotubacione, pusetat, crossing-et, shtyllat e ndriçimit publik, galeritë teknike apo edhe në fasadat e ndërtesave qofshin ekzistuese apo edhe ndertime të reja.
4. Në rregullore përcaktohet organizimi dhe koordinimi me strukturat e brendshme të bashkisë dhe me institucionet e tjera të përfshira në procesin e sistemimit të rrjeteve ajrore të komunikimeve elektronike, detyrë kjo e koordinatorit vendor.

5. Përcaktohet administrimi I infrastrukturës passive si mbajtja e inventarit dhe regjistrit; përcaktohet e drejta e kalimit dhe lejet, godinat dhe pikat e aksesit.
6. Pas implementimit të rrjeteve ajrore të komunikimeve elektronike është përcaktuar dhe sistemimi I zonës.

Bashkëngjitur projekt vendimit:

1. Relacioni shpjegues.
2. Rregullorja për admnistrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e Bashkisë Cërrik.

Faleminderit!

Konceptoi: Xh. Qosja

KRYETARI I BASHKISË
Florenc DOKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA CËRRIK

Nr._____Prot **Cërrik, më:___.___.2026**

RELACION

"Për miratimin e rregullores "Për admnistrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e bashkisë Cërrik"

Të nderuar keshilltarë !

Ky relacion, hartohet në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 55/2025 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa", ligjit nr. 107/2014 "Për zhvillimin e territorit", VKM-ës nr. 155, datë 11.03.2022 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënes së të drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë" dhe VKM-ës nr. 189, datë 30.03.2022 "Për përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina" dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Cërrik, paraqesim para jush kërkesën e domosdoshmërisë që ka Bashkia Cërrik për miratimin rregullores "Për admnistrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e bashkisë Cërrik".

Ju lutemi të merrni në konsideratë kërkesën tonë për miratimin rregullores "Për admnistrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e bashkisë Cërrik", rregullore e cila do të ndikojë në planifikimin, administrimin, koordinimin, ndërtimin dhe përdorimin e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike në territorin e bashkisë Cërrik.

Qëllimi I saj është zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet shumë të lartë, reduktimi i kostove të ndërtimit të rrjeteve, nxitja e përdorimit të pëbashkët të infrastrukturës passive, sistemimi gradual i rrjeteve ajrore, garantimi i aksesit në godina dhe infrastrukturën e brendshme të komunikimeve elektronike, mbështetja e transformimi dixhital dhe zhvillim urban të qëndrueshëm.

Është një domosdoshmëri për standardizimin e rrjeteve kabllore ajrore dhe sistemimin e tyre nëpërmjet kalimit të tyre në kanale nëntokësore në zonat urbane, nëpërmjet infrastrukturave passive si: tubacione, mikrotubacione, pusetat, crossing-et, shtyllat e ndriçimit publik, galeritë teknike apo edhe në fasadat e ndërtesave qofshin ekzistuese apo edhe ndërtime të reja duke e bërë më të lehtë dhe më të sigurtë jetën e banorëve të bashkisë Cërrik.

Miratimi I kësaj regullore do të shërbejë në përmirësimin e pamjes së qytetit së pari, qëndrave me aktivitet kuturor, historik dhe turistik së dyti dhe duke u shtrirë më pas në të gjithë territorin e bashkisë Cërrik.

Faleminderit!
Konceptoi: Xh. Qosja

KRYETARI I BASHKISË
Florenc DOKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA CËRRIK

Nr._____Prot **Cërrik, më:___.___.2026**

PROJEKT-VENDIM

"Për miratimin e Kalendarit të Konsultimeve Publike për projekt-ligjin: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK BASHKIA CËRRIK

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Cërrik:

PROPOZOJMË

1. Të miratohet **Kalendari i Konsultimeve Publike** për projekt-ligjin: *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*,
2. Qëllimi i konsultimit është marrja e mendimeve, sugjerimeve dhe propozimeve, për të garantuar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.
3. **Kalendari i konsultimit**: Konsultimi publik do të realizohet si më poshtë:

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1	Konsultim publik me banorë, biznese, fermerë,OJF, mësues, grupe vulnerabel, etj, në qytetin **Cërrik**	25.09.2026		17.00	Takim publik	Diskutime të hapura
2	Konsultim publik me banorët, biznese, fermerë, mësues, grupe vulnerabel, Kryetarë Fshatrash të Njësisë Administrative **Gostimë**.	23.09.2026	Njësia Adm Gostimë	17.00	Takim publik	Diskutime të hapura
3	Konsultim publik me banorët, biznese, fermerë, mësues, grupe vulnerabel, Kryetarë Fshatrash të Njësisë Administrative **Klos.**	21.09.2026	Njësia Adm Klos	17.00	Takim publik	Diskutime të hapura
4	Konsultim publik me banorët, biznese, fermerë, mësues, grupe vulnerabel, Kryetarë Fshatrash të Njësisë Administrative **Mollas**.	22.09.2026	Njësia Adm Mollas	17.00	Takim publik	Diskutime të hapura
5	Konsultim publik me banorët, biznese, fermerë, mësues, grupe vulnerabel, Kryetarë Fshatrash të Njësisë Administrative **Shalës**.	24.09.2026	Njësia Adm Shalës	17.00	Takim publik	Diskutime të hapura

4. **Pjesëmarrës:**
   - Caktimin e nje komisioni te perbashket prej 7 antaresh (3 antar nga Keshilli Bashkiak dhe 4 nga bashkia Cerrik).

5. **Forma e konsultimit:** Takim publik

Qëllimi i këshillimit publik	Evidentimi i qëndrimeve, mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me projekt-ligjin: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

6. Këshilli Bashkiak Cërrik me anë të këtij projekt-vendimi I bën ftesë të gjithë qytetarëve dhe palëve të interesuara të marrin pjesë aktivisht në këto konsultime publike, duke kontribuar me mendimet dhe sugjerimet e tyre për një vendimmarrje sa më gjithëpërfshirëse dhe në interes të komunitetit.

Bashkëngjitur relacioni shpjegues.

Faleminderit!

Konceptoi: Xh. Qosja

KRYETARI I BASHKISË

Florenc DOKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA CËRRIK

Nr._____Prot **Cërrik, më:___.___.2026**

Lënda**: RELACION**

KËSHILLIT BASHKIAK CËRRIK.

Të nderuar keshilltarë !

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Cërrik, paraqesim para jush kërkesën e domosdoshmërisë që ka Bashkia Cërrik për miratimin e Kalendarit të Konsultimeve Publike për projekt-ligjin: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë",
Konsultimi do të jetë publik dhe do të realizohet në të gjithë territorin e Bashkisë Cërrik si më poshtë vijon:

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1	Konsultim publik me banorë, biznese, fermerë,OJF, mësues, grupe vulnerabel, etj, në qytetin **Cërrik**	25.09.2026		17.00	Takim publik	Diskutime të hapura
2	Konsultim publik me banorët, biznese, fermerë, mësues, grupe vulnerabel, Kryetarë Fshatrash të Njësisë Administrative **Gostimë**.	23.09.2026	Njësia Adm Gostimë	17.00	Takim publik	Diskutime të hapura
3	Konsultim publik me banorët, biznese, fermerë, mësues, grupe vulnerabel, Kryetarë Fshatrash të Njësisë Administrative **Klos.**	21.09.2026	Njësia Adm Klos	17.00	Takim publik	Diskutime të hapura
4	Konsultim publik me banorët, biznese, fermerë, mësues, grupe vulnerabel, Kryetarë Fshatrash të Njësisë Administrative **Mollas**.	22.09.2026	Njësia Adm Mollas	17.00	Takim publik	Diskutime të hapura
5	Konsultim publik me banorët, biznese, fermerë, mësues, grupe vulnerabel, Kryetarë Fshatrash të Njësisë Administrative **Shalës**.	24.09.2026	Njësia Adm Shalës	17.00	Takim publik	Diskutime të hapura

Pjesëmarrës:

- Caktimin e nje komisioni te perbashket prej 7 antaresh (3 antar nga Keshilli Bashkiak dhe 4 nga bashkia Cerrik).

Qëllimi i këshillimit publik	Evidentimi i qëndrimeve, mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me projekt-ligjin: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

Këshilli Bashkiak Cërrik me anë të këtij projekt-vendimi I bën ftesë të gjithë qytetarëve dhe palëve të interesuara të marrin pjesë aktivisht në këto konsultime publike, duke kontribuar me mendimet dhe sugjerimet e tyre për një vendimmarrje sa më gjithëpërfshirëse dhe në interes të komunitetit.

Faleminderit!
Konceptoi: Xh. Qosja

KRYETARI I BASHKISË

Florenc DOKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA CËRRIK

KRYETARI

Nr. _____ Prot. Cerrik, me 28 /07 / 2026

PROJEKT-VENDIM

"PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PERFUNDIMTARE TE SHPENZIMEVE PER PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM VENDOR 2027-2029"

- Ne zbatim te ligjit nr.57/2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Nenit 35, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
- Nenit 8, pika 8(b), dhe Nenit 27 të Ligji Nr. 10296/2010, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",
- Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.202018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.202018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimit nr. 17, datë 10.07.2026 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për pregatitjen e programit buxhetor afatmesëm Vendor 2027-2029."

Kryetari I Bashkise mbasi u njohe me Vlersimet dhe rekomandimet e Ministrise se Financave per Programin buxhetor Afatemesem 2027-2029 derguar me shkresen nr.10436.Prot,date 16/06/2026,diskutoj me grupin per menaxim strategjik keto konkluzione ,Vendosi te sjell per per miratim Tavanet perfundimtare te PBA 2027-2029.

Si me poshte:

A- Te miratohet Raporti i vlersimit dhe parashikimit afatmesem te te ardhurave sipas tabeles bashkengjitur

Ne parashikimin e burimeve eshte mbajtur parasyshe kapaciteti fiskal i Bashkise ,Vlersimi i realizimit te ardhurave ne 3 vitet e fundit,si dhe trasfertat e derguara nga Ministria e Financave

	Vlersimi I te Ardhurave per vitet 2027-2029							
	Vitet	N-2	N-1	N	N+1	N+2	N+3	
Nr	Burimi buxhetor	Fakt 2024	Fakt 2025	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029	Ne %
I	Nga te Ardhurat	139607	166926	310318	220300	237800	259800	32.8
1	Të ardhura nga taksat loka	48261	60507	178659	98535	108570	119385	
2	Të ardhura nga taksat e nd	28299	34063	34890	35560	37140	39065	
3	Të ardhura nga tarifa vend	35501	43547	66030	53885	56115	61730	
4	Të ardhurat e tjera	27546	28809	30739	32320	35975	39620	
II	Transferta e pakushtëzuar	238454	312707	280983	294133	307681	321239	43.8
III	Trasferta specifike	124315	137842	154224	157308	157308	158881	23.4
IV	Grand Performance	0	4404					
V	Te ardhura te Tjera	38220	33220	65810	0	0	0	
1	Trashëgimi pa destinacion	9342	7676	17654	0			
2	Trashëgimi me destinacion	28878	25544	48156	0			
XX	TOTALI Burime te Veta	540596	655099	811335	671741	702789	739920	100
	Ritja ne % ndaj vitit N-1			123.8	82.8	104.6	105.3	

B- Te miratojme tavanet shpenzimeve sipas Llogarive Ekonomike te Programit Buxhetor Afatmesem 2027-2029 (ne 000/leke),si me poshte:

Për të garantuar që procesi i planifikimit të shpenzimeve sipas programeve të jetë në përputhje ,me parashikimin e të ardhurave, stabilitetin fiskal si dhe prioritetet strategjike të Bashkisë, është e domosdoshme vendosja e tavaneve të shpenzimeve.

Me shpërndarjen e Tavaneve Përgatitore të PBA 2027-2029 për cdo program buxhetor, garantohet që shpenzimet të planifikohen në përputhje me burimet e te ardhurave.
Nisur nga ky fakte ne kemi sjell per miratim Tavanet Perfundimtare buxhetore sipas Tabeles Bashkengjitur .

Planifikimi i Tavaneve buxhetore në PBA 2027-2029 sipas llogarive Ekonomike.

Nr	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2027		Viti 2028		Viti 2029	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	255837	38.1	255837	36.4	257639	34.8
2	Sigurime (601)	43339	6.5	43339	6.2	43709	5.9
3	Shpenzime operative (602)	145895	21.7	151896	21.6	151547	20.5
4	Shpenzime (603)						
5	Shpenzime (604)	2452	0.4	2919	0.4	3060	0.4
6	Shpenzime (606)	21393	3.2	22293	3.2	23278	3.1
7	Shpenzime (609)	5000	0.7	5000	0.7	5000	0.7
	Shpenzime për investime 230	7580	1.1	6510	0.9	9510	1.3
8	Shpenzime për investime 231	190245	28.3	214995	30.6	246177	33.3
	TOTALI	671741	100	702789	100	739920	100
	Rritja %(n-1)			104.62		105.28	

Tavanet perfundimtare te Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2027-2029 simbas programeve buxhetore si me Poshte:

[1]Kodi	Programet	2027			2028			2029		
[1]		600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231
1110	-Planifikim &Administrim	71500.00	19252.00	3000.00	71500.00	20219.00	3000.00	72500.00	20481.00	3000.00
3140	-Sherbime Policore	7000.00	700.00		7000.00	700.00		7000.00	700.00	0.00
3280	-Sherbime MKZ	17300.00	4184.00	775.00	17300.00	4184.00	775.00	17500.00	4201.00	780.00
4220	-Bujq,Insp.Ushqimi	14380.00	800.00		14380.00	800.00		14380.00	800.00	
4240	-Uitja &Kullimi	6100.00	14216.00	9800.00	6100.00	14216.00	9800.00	6300.00	14219.00	9800.00
4260	-Pyjet	4349.00		50.00	4349.00		1980.00	4380.00		
4520	-Rrjeti Rrugor		17079.00	124027.00		19080.00	126125.00		19100.00	177487.00
5100	-Menaxhimi I mbetjeve	10300.00	54216.00		10300.00	54216.00		10300.00	54326.00	
6140	-Ndertimi dhe Urbanistika	18900.00	1700.00	3710.00	18900.00	1700.00	10078.00	18900.00	1700.00	
6260	-Sherbimet Publikje Vendore	35100.00	11000.00	43962.00	35100.00	14000.00	58998.00	35100.00	13000.00	56941.00
8130	-Sporti & argetimi	6420.00	8500.00		6420.00	8700.00		6420.00	9000.00	
8220	-Arti & Kultura	4670.00	4500.00		4670.00	4500.00		4670.00	4500.00	4091.00
9120	-Arsimi baz&Parashkollor	74000.00	12593.00	12500.00	74000.00	13093.00	10749.00	74600.00	13334.00	3588.00
9230	-Arsimi I Mesem	8727.00	2500.00		8726.00	2800.00		8814.00	2800.00	
9240	-Arsimi Profesional	8731.00			8731.00			8785.00		
10430	-Kujdes Social	11700.00	7300.00		11700.00	7500.00		11700.00	8323.00	
4910	-Fonde Rezerve		5000.00			5000.00			5000.00	
4940	-Fond Emergjence		11200.00			11400.00			11400.00	
	SHUMA	**299177.00**	**174740.00**	**197824.00**	**299176.00**	**182108.00**	**221505.00**	**301349.00**	**182884.00**	**255687.00**
	Tavanet Gjithesej			**671741**			**702789**			**739920**
	Kontrolli			**648389**			**671870.00**			**697009**
				23352	0	0	30919	0	0	42911
	Ne % ndaj totalit te Shpenzim	44.54	26.01	29.45	42.57	25.91	31.52	40.73	24.72	34.56

Tavanet perfundimtare te Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2027-2029 , do t'ju shpërndahen Drejtuesve të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve, sapo të miratohen nga Këshilli Bashkiak" .

Duke ju falenduruar per bashkpunimin ju ftoj te miratojme kete projekte vendim.

Ju faleminderit .
Dr.Financës
H. Kumria

KRYETARI I BASHKISË

Florenc DOKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA CËRRIK

RREGULLORE

"PËR ADMNISTRIMIN E INFRASTRUKTURËS SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE NË TERRITORIN E BASHKISË CËRRIK"

CËRRIK 2026

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat për planifikimin, administrimin, koordinimin, ndërtimin dhe përdorimin e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike në territorin e bashkisë Cërrik, me qëllim:

a) Zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet shumë të lartë;
b) Reduktimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve;
c) Nxitjen e përdorimit të pëbashkët të infrastrukturës passive;
d) Sistemimin gradual të rrjeteve ajrore;
e) Garantimin e aksesit në godina dhe infrastrukturën e brendshme të komunikimeve elektronike;
f) Mbështetjen e transformimit dixhital dhe zhvillimit urban të qëndrueshëm.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

a) Ligjin Nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*";
b) Ligjin nr. 120/2016 *"Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit";*
c) Ligjin nr. 54/2024 "*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";*
d) Ligjin nr. 55/2025 *"Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa";*
e) VKM nr. 155, datë 11.03.2022 *"Për miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënes së të drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë".*
f) VKM nr. 189, datë 30.03.2022 *"Për përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina"*.
g) VKM nr. 190, datë 30.03.2022 *"Për miratimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile*".
h) VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit",* e ndryshuar.
i) VKM nr. 22, datë 11.03.2022 *"Për përcaktimin e kategorive të ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi I pikës së aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike".*
j) Vendimi I Këshillit Bashkiak Cërrik nr. 83, datë 26.12.2025 *"Për nivelin e taksave e tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2026"*.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e legjislacionit në fuqi.

Në veçanti:

a) "PAG"- Pika e Aksesit në Godinë;
b) "KTG"- Kaseta Teknike e Godinës;
c) "Crossing" – lidhja nëntokësore ndërmjet korridoreve infrastrukturore të vendosura në anë të ndryshme të rrugës;
d) "Tubacion lidhës" – segmenti që lidh korridorin publik të komunikimeve elektronike me PAG/KTG të godinës;
e) "Infrastrukturë passive" – tubacione, mikrotubacione, pusetat, crossing-et, galeritë teknike, shtyllat dhe elementë të tjerë mbështetës.

KREU II
ORGANIZIMI DHE KOORDINIMI

Neni 4
Koordinatori vendor

4.1 Bashkia siguron koordinimin e brendshëm ndërmjet strukturave përgjegjëse për:

- Planifikimin urban;
- Administrimin e infrastrukturës publike;
- Lejet e zhvillimit;
- Mirëmbajtjen e rrugëve;
- Ndriçimin publik;
- Policinë Bashkiake.

4.2 Bashkia cakton një Koordinator Vendor, për komunikimet elektronike përgjegjës për koordinimin me AKEP, me operatorët; me OSSH dhe institucionet e tjera, si dhe monitorimin e zbatimit të kësaj rregullore. Koordinatori Vendor do të jetë një strukturë e ngritur me urdhër të posaçëm për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

4.3 Në faqen e internetit të Bashkisë Cërrik të publikohen detajet e kontaktit (nr. Tel, email, adresë fizike) të Koordinatorit Vendor.

KREU III

ADMINISTRIMI I INFRASTRUKTURËS PASIVE

Neni 5

Inventatri I infrastrukturës Pasive

5.1 Bashkia evidenton dhe mban informacion të përditësuar mbi infrastrukturën pasive në administrimin e saj, duke përfshirë;

a) tubacione,
b) mikrotubacione,
c) pusetat,
d) crossing-et,
e) shtyllat e ndriçimit publik;
f) galeritë teknike,
g) asetet e tjera publike që mund të përdoren për rrjetet e komunikimeve elektronike.

5.2 Bashkia identifikon kapacitetet e lira ose potencialisht të përdorshme për sistemimin e rrjeteve ekzistuese ajrore.

5.3 Bashkia identifikon zonat ku mungon infrastruktura pasive dhe planifikon ndërtimin e saj në përputhje me programet e investimeve.

5.4 Bashkia publikon në faqen zyrtare informacion mbi planin e investimeve për shtrimin e infrastrukturës pasive.

Neni 6

Regjistri Vendor I Infrastrukturës pasive

Bashkia krijon dhe mirëmban Regjistër vendor të infrastrukturës pasive dhe bashkëpunon me AKEP për integrimin e informacionit në sistemet kombëtare të informacionit.

Regjistri vendor i infrastrukturës pasive publikohet në sistemin e përqëndruar te informacionit (ATLAS) që administrohet nga AKEP.

KREU IV

E DREJTA E KALIMIT DHE LEJET

Neni 7

Parimet e përgjithshme

7.1 Bashkia administron kërkesat për të drejtë kalimi dhe ndërtim infrastrukture sipas ligjit nr. 120/2016 dhe VKM nr. 155/2022.

7.2 Procedurat duhet të jenë transparente, jodiskriminuese, proporcionale dhe të bazuara në përdorimin efikas të hapësirës publike.

Neni 8

Koordinimi I Punimeve Civile

8.1 Bashkia promovon koordinimin e punimeve civile dhe zbatimin e parimit “Dig Once”, në zbatim të ligjit nr. 120/2016 dhe VKM nr. 155/2022.

8.2 Bashkia në rastin ku planifikon të kryejë investime publike në rrugë, trotuare, sheshe dhe hapësira publike duhet të publikojë të paktën informacionin mbi:

a) Vendndodhjen dhe llojin e punimeve;
b) Elementet e infrastrukturës fizike të përfshirë (tubacione komunikimesh elektronike; pusetat; crossing-et; tubacionet lidhëse per godinat).
c) Datën e parashikuar për fillimet e punimeve dhe kohëzgjatjen e tyre;
d) Pikën e kontaktit.

Neni 9

Lejet për Infrastrukturën e Komunikimeve Elektronike

9.1 Bashkia miraton standardet teknike të posaçme për ndërtimin e tubacioneve, pusetave, crossing-et, lidhjen e godinave me rrjetin publik si dhe sistemin e rrjeteve ajrore.

9.2 Në zbatim të pikës të nenit 13 të VKM 155/2022, bashkia duhet:

- të publikojë rregullat për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit në faqen zyrtare të internetit;
- të qartësojë procedurat dhe afatet e shqyrtimit të aplikimit. në çdo rast, afati I shqyrtimit të mos jetë më I gjatë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e aplikimit;
- për projektin pilot/sistemim kabllosh ajrore sipas nenit 40 të ligjit nr. 120/2016 afati të mos jetë më shumë se 7 ditë pune;

9.3 Bashkia gjatë shqyrtimit të aplikimeve për leje për ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, nëse në zonën e kërkuar ekziston infrastrukturë fizike e bashkisë, I propozon sipërmarrësit kërkues përdorimin e saj.

KREU V

GODINAT DHE PIKAT E AKSESIT

Neni 10

Pika e Aksesit në Godinë

10.1 Bashkia zbaton VKM-në nr. 189/2022 për pikat e aksesit në godinë dhe infrastrukturën e brendshme të komunikimeve elektronike.

10.2 Bashkia zbaton përcaktimet e VKM nr. 408/2015 *“Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit”,* e ndryshuar, veçanërisht në mbikëqyrjen e punimeve dhe aktet e kontrollit me qëllim verifikimin e respektit të detyrimit për pikën e aksesit në godinë.

10.3 Pika 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohen për ndërtesat e reja si edhe për ndërtesat ekzistuese, kur Bashkia jep leje për punime infrastrukturore/ rinovimi/ fasade etj. (pika 24 e VKM 189/2022).

Në lejet e dhëna për punimet e rikonstruksionit, rindërtimit apo punimeve rinovuese (përfshirë punime në fasadë) në ndërtesat ekzistuese, bashkia përfshin detyrime për ndërtuesit sipas VKM 189/2022 për pikën e aksesit në godinë dhe rrjetin e brendshëm, dhe kontrollon zbatimin e saj sipas VKM 408/2015.

Neni 11

Kaseta Teknike e Godinës

Për ndërtesat e reja, dhe ndërtesat ekzituese sipas pikës 11.4, bashkia verifikon zbatimin e lejes për ekzistencën/ instalimin e KTG dhe Infrastrukturës së brendshme të komunikimeve elektronike sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Administratorët e Ndërtesave

12.1 Në zbatim të ligjit nr. 55/2025 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa", bashkia:

a) verifikon respektimin e detyrimit për akses të paanshëm dhe jodiskriminues të operatorëve;
b) evidenton rastet e refuzimit të pajustifikuar të aksesit;
c) njofton administratorët dhe strukturat përgjegjëse për marrjen e masave sipas legjislacionit në fuqi.

12.2 Bashkia ndërmerr masat administrative dhe procedural sipas kompetencave të përcaktuara ne ligjin nr. 55/2025.

KREU VI

SISTEMIMI I RRJETEVE AJRORE

Neni 13

Zonat Pilot

Bashkia në kuadër të projektit "Sistemimi I rrjeteve ajrore" koordinon me AKEP dhe operatorët për përcaktimin e zonave pilot për sistemimin e rrjeteve ajrore në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 120/2016.

Neni 14

Plani Teknik I Sistemimit

Për çdo zonë pilot, do të hartohet plan teknik që përfshin:

a) rrjetin ekzistues,
b) korridoret kryesore nëntokësore,
c) pusetat,
d) crossing-et,
e) lidhjet me godinat,
f) PAG dhe KTG,
g) afatet e migrimit.

Neni 15

Ndërtimi dhe bashkëpërdorimi I Infrastrukturës

15.1 Bashkia promovon përdorimin e përbashkët të infrastrukturës pasive sipas legjislacionit në fuqi (ligji 120/2016) dhe akteve rregullatore te AKEP (Rregullore 35/2015).

15.2 Në rastet kur tubacionet mungojnë apo plani I investimeve nuk parashikon kryerjen e investimeve për tubacione të reja në dy vitet e ardhme, bashkia pajis një apo një grupim sipërmarrësish me leje për fillimin e punimeve për shtrirjen e tubacioneve nëntokësore me parimin "Gërmo një herë", duke garantuar kapacitet të mjaftuehëm për bashkëpërdorim nga operatorë të tjerë.

15.3 Leja, sipas pikës 2, të këtij neni, I jepet një grupimi operatorësh të rrjeteve dhe/ose një operatori, në raste të justifikuara, kur ajo çon në sistemimin e plotë të rrjeteve kabllore ajrore ekzistuese të komunikimeve elektronike në zonat urbane dhe kundrejt detyrimit për bashkëpërdorim të infrastrukturës e koordinim të punimeve civile.

15.4 Pas përfundimit të ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore Bashkia njofton të gjithë operatorët prezentë në zonë për migrimin e rrjetave të tyre ajrore në infrastrukturën nëntokësore, brenda 15 ditëve nga data e mjoftimit.

15.5 Pas përfundimit të migrimit, bashkia kryen heqjen e kabllove ajrore dhe strukturave të tjera mbështetëse (shtylla etj).

Neni 16

Zona të Sistemuara

Bashkia duhet të mbajë parasysh në shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi, përdorimin e infrastrukturës së bashkisë apo infrastrukturave të tjera fizike me qëllim shmangjen e vendosjes së kabllove ajrore në zonat e sistemuara.

Çdo vendosje kablli ajror në mënyrë të jashtligjshme në zonat e sistemuara, përbën shkelje administrative dhe dënohet nga Bashkia në përputhje me rregulloren përkatëse të shkeljeve administrative.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Bashkëpunim Institucional

17.1 Strukturat e varësisë të bashkisë, (drejtoritë e infrastrukturës, ndriçimit publik dhe Policinë Bashkiake), bashkëpunjnë për zbatimin e kësaj rregulloreje.

17.2 Bashkia bashkëpunon me AKEP, operatorët, OSSH dhe institucionet e tjera për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi sipas vendimit të Këshillit Bashkiak.

Konceptoi: Xh. Qosja